



Pranuar / Doretuar Puniljena/Prodato Received/Delivety	06.07.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHUK	3962/2022		1/1



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.454/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.454/2022 të datës 13.05.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë rruga [redacted] në Prishtinë, kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në punë të datës 15.04.2022, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.07.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.454/2022 e datës 13.05.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II. Mbetet në fuqi formulari për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesin për vitin 2021 i datës 15.04.2022.

### A r s y e t i m

Zëvendësuesi i Udhëheqësit të Skemave Pensionale në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, më datë 15.04.2022 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 për ankuesen [redacted] e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 11.06.2012 në pozitën Menaxhere e Komisionit Mjekësor, të cilën ankuesja ka refuzuar t'a nënshkruaj.

Ankuesja e pakënaqur me këtë vlerësim, më datë 13.05.2022 fizikisht ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:2793/2022 në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 01.06.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Këshilli, me datë 01.07.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 27.06.2022 ka nxjerr Vendim VK.nr.62/2022 me të cilin ka aprovuar kërkesën për shtyrje të afatit për vendosje për dhjetë (10) ditë pune për ankesën e ankueses.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.Prot:2793/2022 e datës 13.05.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesme, Ulet dhe Profesionale për vitin 2021 më datë 15.04.2022; Përgjigje në padi A.nr.474/19; Autorizim përmes emailit i datës 07.09.2021 për ankuesen; Shkresë me titull lëndët të trajtuara pas aktgjykimit të Gjykatës; Shkresë me titull lëndë për përgjigje në padi; Shkresë me titull dorëzimi i lëndëve për përgjigje në padi datë 15.09.2021, 29.07.2021; Shkresë me titull lëndët për gjykatë më datë 21.06.2021; Email i datës 24.12.2020 për ankuesen; Emailin e datës 23.07.2021 për ankuesen; Emailin e datës 23.07.2021 nga Emailin e datës 19.08.2021, 25.10.2021, 18.10.2021, 29.12.2021 për ankuesen; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 01.06.2022; Vendimin VK.nr.62/2022 i datës 27.06.2022 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë e datës 01.07.2022; Akt Emërimit e datës 11.06.2012; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 15.01.2020, 25.01.2021; Emailin e datës 26.03.2021 nga për ankuesen; Emailin e datës 05.05.2021, 27.04.2021 nga për Emailin e datës 13.05.2019 dhe 24.04.2019 nga Kërkesë për Komision Disiplinor e datës 29.06.2019; Vërejtjen e datës 04.04.2019; Vendimin e datës 17.04.2019; Shkresë me titull mungesat e 2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të çështjes në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e pa bazuar, sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2021 të datës 15.04.2022, pretendon që vlerësimi është bërë në kundërshtim me rregulloren përkatëse për vlerësimin e rezultateve në punës, është skandaloz dhe joprofesional

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe provave të lëndës, konstaton që Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesme, Ulet dhe Profesionale për vitin 2021, ankuesja është vlerësuar me notë të përgjithshme 3.0 që nënkupton mirë.

Referuar dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 43 paragrafi 1 dhe 2, është përcaktuar që: 1. *Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues.* 2. *Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit”,* ndërsa neni 5 paragrafin 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike përcakton se: *“Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuar; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar)”*, rrjedhimisht në bazë të provave të lëndës, vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen është bërë në kuadër të objektivave të përcaktuar në këtë formularë. Lidhur me vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen që është bërë më datë 15.04.2022, Kolegji në bazë të provave të lëndës, ka gjetur që ankuesja nuk ka qenë e regjistruar në sistemin HRMIS deri në muajin shkurt dhe sipas deklaratës së udhëheqësit të drejtpërdrejtë ka qenë e pamundur të bëhet vlerësimi elektronik, bazuar në këtë fakt dhe në shkresat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se edhe pse vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen nuk është bërë në kohën e duhet siç parashihet me nenin 43 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ankuesja nuk është mbetur pa u vlerësuar dhe nuk i është mohuar e drejta për vlerësim dhe ankim ndaj vlerësimit.

Duke u bazuar në provat e lëndës si dhe formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021, del se ankuesja nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë është vlerësuar me notën e përgjithshme 3.0, që nënkupton se ka arritur të gjitha objektivat në kuptim të nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se; 1. *Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: 1.3. nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton “mirë”,* ndërsa në kuadër të kuptimit të notave sipas paragrafit 2 nën paragrafit 2.3 të këtij neni, përcaktohet që: *“mirë”, vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës”,* bazuar në këtë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që ankuesja nuk ka ofruar asnjë dëshmi që do të mund të dëshmonte që ka bërë tejkalim të objektivave apo të ketë tejkaluar pritjet, rrjedhimisht, vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen është bërë në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 4, 5 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3, nenin 8, nenin 10, nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara, duke marrë parasysh që në bazë të provave të lëndës, ankueses përmes emailit të datës 26.03.2021 nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i është tërhequr vëreja që nuk ka raportuar për periudhën nga data 19.03.2021 deri më datë 26.03.2021, po ashtu më datë 27.04.2021 ankueses i është shqiptuar vërejtje për shkak të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, ndërsa më

datë 05.05.2021 nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë ankesës prapë i është shqiptuar vërejtje për shkak të keqpërdorimeve zyrtare.

Nga të gjitha të lartcekurat dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson së ankuesja meqenëse është vlerësues me notë të përgjithshme 3.0, që nënkupton mirë dhe ka arritur të përmbush objektivat, atëherë ne nuk kemi pasur prova me të cilat do të dëshmohet që ky vlerësim ndaj ankuses ka qenë tendencioz dhe subjektiv.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRTËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.454/2022

**Avdyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

